

VENDIM
Nr. 410, datë 27.6.2012

**PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE DHE TË PROCEDURAVE TË NDRYSHIMIT
TË KATEGORIVE TË RESURSEVE TË TOKËS**

(Ndryshuar me VKM nr. 440, datë 3.6.2020)

(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 11/1 të ligjit nr. 8752, datë 26.3.2001 “Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës”, të ndryshuar, me propozimin e *Ministrit përgjegjës për bujqësinë*, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. PËRKUFIZIME

Në kuptim të këtij vendimi, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Ndryshimi i tokave bujqësore në kategori të resurseve të tjera dhe anasjelltas”, veprimet procedurale e dokumentare dhe miratimet që bëhen nga strukturat shtetërore, të përcaktuara në këtë vendim, që sjellin për pasojë ndryshimin e tokës bujqësore në kategori të resurseve të tjera apo ndryshimin e kategorive të resurseve të tjera në tokë bujqësore. Ky ndryshim pasqyrohet në dokumentacionin kadastral shtetëror.

2. “Subjekte të interesuara për ndryshimin e kategorive të resurseve”:

a) personat, fizikë a juridikë, të cilët e kanë në pronësi private tokën bujqësore, tokën me bimësi pyjore, pyllin, kullotën, livadhin, tokën e pafrytshme dhe që shprehin interes apo kërkojnë ndryshimin nga një kategori resursi në një kategori tjetër;

b) organet e qeverisjes vendore apo institucione të tjera shtetërore që, bazuar në akte ligjore ose nënligjore, kanë në administrim/përdorim apo në pronësi tokën bujqësore, tokën me bimësi pyjore, kullotën, livadhin, tokën e pafrytshme, sipërfaqe të brigjeve të lumenjve, sipërfaqe këto në pronësi shtetërore (publike) dhe që shprehin interes apo kërkojnë ndryshimin e një kategorie resursi në një kategori tjetër.

3. “Subjekte të interesuara për ndryshim të tokës bujqësore në tokë urbane (truall), në tokë për veprimtari minerare e gjeologjike, për gurore dhe karriera”:

a) personat, fizikë a juridikë, që ushtrojnë kërkesën pranë ministrive përkatëse që mbulojnë këto veprimtari;

b) ministritë përkatëse dhe autoritetet e planifikimit, që kanë kompetencë dhe përgjegjësi për planifikimin e territorit, sipas legjislacionit në fuqi.

4. “Subjekte të interesuara për kalimin e tokave bujqësore të kategorive nga I deri në IV të bonitetit për ushtrim të veprimtarive të domosdoshme”:

a) personat, fizikë a juridikë, që kërkojnë zhvillimin e veprimtarisë mbi këto toka;

b) ministritë përkatëse që mbulojnë veprimtarinë për të cilën kërkohet kalimi.

II. NDRYSHIMI I TOKAVE NGA KATEGORITË E RESURSEVE PYLL, TOKË ME BIMËSI PYJORE, KULLOTË DHE LIVADH NË KATEGORINË E RESURSTIT TOKË BUIJQËSORE

1. Subjekti i interesuar për ndryshimin e kategorive të resurseve pyll, tokë me bimësi pyjore, kullotë e livadh dhe kalimin e tyre në tokë bujqësore, mund të paraqesë kërkesë në njësinë e qeverisjes vendore, ku ndodhen këto sipërfaqe, e cila përmban:

- identitetin e kërkuarit;

- dokumentin e noterizuar të disponimit të këtyre resurseve në pronësi, sipas ligjit;
- planimetrinë e sipërfaqes për të cilën kërkohet ndryshimi, me kufijtë qartësisht të përcaktuar në shkallën 1: 2500.

- vërtetimin për gjendjen e kategorisë së resursit, me të cilën figuron kjo sipërfaqe në dokumentacionin kadastral, të lëshuar përkatësisht nga Drejtoria e Shërbimit Pyjor (DSHP) apo Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës (DAMT) e qarkut;

- projektin e hollësishëm e të argumentuar për veprimtarinë që do të ushtrojë në sipërfaqen e kërkuar për ndryshim të kategorisë së resursit.

2. Komisioni i ndryshimit të kategorive të resurseve, i bashkisë, me pjesëmarrjen e të gjithë anëtarëve të tij, e shqyrton kërkesën brenda afateve të përcaktuara në shkronjën “c” të pikës 4 të nenit 11/1 të ligjit nr. 8752, datë 26.3.2001, të ndryshuar, dhe merr vendimin përkatës.

3. Në rastin e miratimit të ndryshimit të kategorive të resurseve objekt kërkese dhe të kalimit të tyre në kategorinë e resursit tokë bujqësore, vendimi përgatitet në 4 (katër) kopje, nga të cilat një kopje i jepet subjektit kërkues, një kopje mbahet në ZMMT-të e bashkisë, një kopje i dërgohet DAMT-së së qarkut dhe kopja e katërt i dërgohet Drejtorisë së Shërbimit Pyjor, në bazë të së cilës kryhen veprimet e përcaktuara në kreun VIII të këtij vendimi.

4. Në rastin e mosmiratimit të kërkesës për ndryshim të kategorive të resurseve pyll, tokë me bimësi pyjore, kullotë dhe livadhe për kalimin e tyre në kategorinë e resursit tokë bujqësore, për sipërfaqen e plotë apo sipërfaqen e pjesshme objekt kërkese, vendimi me shkrim i komunikohet subjektit kërkues, brenda 5 (pesë) ditëve nga data e marrjes së tij. Në vendim pasqyrohen shkaqet e mosmiratimit të kërkesës.

5. Subjekti që ka paraqitur kërkesë për ndryshim të kategorive të resurseve, si në rastin kur komisioni i bashkisë e rrëzon kërkesën, siç përcaktohet në pikën 4 të këtij kreu, ashtu edhe në rastet kur bashkia nuk e kanë marrë atë në shqyrtim brenda afatit prej 30 (tridhjetë) ditësh nga regjistrimi i saj, ka të drejtë ta paraqesë këtë kërkesë për vendimmarrje në *ministrinë përgjegjëse për bujqësinë*.

6. Struktura përgjegjëse e administrimit të tokave në MBUMK e shqyrton kërkesën brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve dhe në rastin kur ajo është në përputhje me kriteret e përcaktuara në ligj e me procedurat e përcaktuara në pikat 1 deri 5 të këtij kreu, e vlerëson atë për t'u miratuar dhe ia dërgon për mendim *Ministrisë përgjegjëse për mjedisin*, e cila shprehet me shkrim brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve. Kur mendimet e të dyja ministrive rezultojnë me vlerësim të njëjtë për miratimin e ndryshimit të kategorisë së resursit, struktura përgjegjëse e administrimit të tokës në *ministrinë përgjegjëse për bujqësinë* përgatit urdhrin e ministrit për miratim brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga marrja e *mendimit të ministrisë përgjegjëse për mjedisin*.

Urdhri i ministrit i njoftohet subjektit kërkues dhe i dërgohet për zbatim bashkisë dhe DAMT-së së qarkut.

III. NDRYSHIMI I TOKËS BUJQËSORE NË KATEGORI TË RESURSEVE PYLL, KULLOTË DHE LIVADH

1. Tokat bujqësore të kategorive nga I deri në IV të bonitetit nuk lejohet të kalojnë në kategori të resurseve pyll, kullotë dhe livadh.

2. Kur subjekti i interesuar për ndryshimin e kategorisë së resursit tokë bujqësore në kategori të resurseve pyll, kullotë dhe livadh është pronar privat, e paraqet kërkesën në MBUMK, e cila përmban:

- identitetin e kërkuesit;
- përshkrimin e veprimtarisë që do të ushtrojë në sipërfaqen e kërkuar për kalim;
- fotokopjen e noterizuar të dokumentit të pronësisë mbi tokën;
- planimetrinë e sipërfaqes për të cilën kërkohet kalimi, me kufijtë e saj qartësisht të dallueshëm;

- vërtetimin origjinal, të lëshuar nga Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës (DAMT) e qarkut, për kategorinë e resursit me të cilën figuron kjo sipërfaqe në dokumentacionin kadastral dhe për kategorinë e tokës sipas bonitetit.

3. Kur subjekti kërkues për ndryshimin e kategorisë së resursit tokë bujqësore, në pronësi të shtetit është organi i qeverisjes vendore, që me akte ligjore ose nënligjore i disponon këto sipërfaqe në administrimin/përdorimin, ia paraqet kërkesën për kalim të tyre në kategori të resurseve pyll, kullotë dhe livadh MBUMK-së. Kërkesa përmban:

- identitetin e subjektit të interesuar për ndryshimin e tokës bujqësore në kategori të resurseve të tjera;

- përshkrimin e qëllimit dhe veprimtarisë që do të ushtrohet në sipërfaqen e kërkuar për ndryshimin;

- fotokopjen e aktit ligjor ose nënligjor, që vërteton qenien në administrim apo përdorim të sipërfaqes së tokës për të cilën kërkohet ndryshimi;

- planimetrinë e sipërfaqes, objekt të propozimit, me kufijtë qartësisht të përcaktuar;

- vërtetimin e DAMT-së për kategorinë e resursit, me të cilën figuron kjo sipërfaqe në dokumentacionin kadastral, si dhe për kategorinë e tokës sipas bonitetit.

4. Struktura që mbulon administrimin e tokave në MBUMK shqyrton kërkesën e paraqitur, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga regjistrimi i saj, në lidhje me ligjshmërinë, dokumentacionin përbërës dhe efektivitetin ekonomik që rrjedh nga ndryshimi i kategorisë së resursit, në përputhje me programet mbështetëse të qeverisë për bujqësinë.

Në çdo rast të vlerësimit pozitiv të kërkesës, kjo strukturë përgatit:

a) urdhrin e ministrit për miratimin e ndryshimit të kategorisë së resursit të tokës bujqësore dhe kalimin e saj përkatësisht në kategorinë e resursit pyll, kullotë dhe livadh, kur sipërfaqja që propozohet për kalim është deri në 5 (pesë) ha;

b) projektvendimin e Këshillit të Ministrave, kur sipërfaqja e tokës bujqësore që propozohet për kalim në kategoritë e resurseve pyll, kullotë apo livadh është mbi 5.1 ha.

5. Kur ministri vlerëson se kërkesa nuk i përmbush kriteret e përcaktuara, gjë që sjell, për pasojë, mosmiratimin e saj brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, njofton subjektin që ka paraqitur kërkesën.

IV. NDRYSHIM I TOKËS SË PAFRYTSHME DHE TOKË URBANE, TRUALL, NË KATEGORINË E RESURSIT TOKË BUJQËSORE

1. *Subjekti i interesuar për ndryshim të kategorisë së resursit, nga tokë e pafrytshme ose tokë urbane, truall, në kategorinë e resursit “tokë bujqësore”, paraqet kërkesë në Qendrën e Transferimit të Teknologjive Bujqësore Fushë-Krujë. Kërkesa përmban:*

a) *dokumentin e pronësisë, kartelën e pasurisë së paluajtshme, shoqëruar me hartën kadastrale ose planin e rievimit, të përgatitur sipas standardit të miratuar nga një ekspert topograf i licencuar, ku të përcaktohen qartë kufijtë e pronës. Kur subjekti është institucion shtetëror dhe e ka tokën në administrim, paraqet aktin mbi të cilin e ka marrë në përgjegjësi administrimi ose në përdorim;*

b) *vërtetimin për gjendjen e resursit, lëshuar nga Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës, e qarkut.*

2. *Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore Fushë-Krujë merr mostra në terren për profilin dhe numrin e tyre për çdo parcelë, sipas rregullave të miratuara nga ministri me udhëzim. Pagesa për kryerjen e analizave dhe shpenzimet për marrjen e mostrave, sipas tarifave të miratuara, kryhet nga subjekti i interesuar.*

3. *Qendra e Transferimit të Tokës Bujqësore Fushë-Krujë përgatit rezultatin e analizave dhe raportin teknik dhe, në përputhje me konkluzionet, propozon kalimin e sipërfaqes së tokës në tokë bujqësore ose refuzimin e kërkesës. Raporti i analizave, raporti teknik dhe dokumentacioni i paraqitur nga subjekti, përcillet në ministrinë përgjegjëse për bujqësinë, shoqëruar me propozimin për pranimin ose refuzimin e kërkesës.*

4. Dokumentacioni shqyrtohet nga struktura/ sektori i administrimit të tokave në ministrinë përgjegjëse për bujqësinë, i cili përgatit raport përmbledhës për ministrin, bashkë me projekturdrin përkatës.

5. Ministri përgjegjës për bujqësinë, në bazë të procedurës së kryer nga Qendra e Transferimit të Tokës Bujqësore Fushë-Krujë dhe raportit të strukturës/ sektorit të administrimit të tokave në ministri, miraton me urdhër ndryshimin në resursin tokë bujqësore.

6. Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës, ku ndodhet toka, bën ndryshimin në bazë të përcaktimeve të urdhrin të ministrit.

7. Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës bën ndryshimin e llojit të pasurisë sipas procedurës më sipër, me kërkesën e subjektit të interesuar dhe pas kryerjes së pagesës së tarifave nga ky i fundit ose personi i autorizuar prej tij.

V. NDRYSHIMI I TOKËS BUJQËSORE NË KATEGORINË E RESURISIT TOKË E PAFRYTSHME

1. Subjekti i interesuar për ndryshimin e kategorisë së resursit tokë bujqësore dhe kalimin e saj në kategorinë e resursit tokë e pafrytshme, ka të drejtë kërkesë për ndryshim vetëm kur mbi këtë sipërfaqe toke bujqësore kanë vepruar faktorët natyrorë të fuqisë madhore, si: tërmete, rrëshqitje masive të sipërfaqeve të tokës, përmbajtje, vullkane, zjarre masive, fundosje të shtresave të tokës dhe të tjerë faktorë të kësaj natyre.

Veprimi i faktorëve natyrorë të fuqisë madhore kërkohet të jetë i dokumentuar me procesverbalin e kohës së dëmtimit, të konfirmuar (nënshkruar) nga *specialisti i Agjencisë Rajonale të Ekstensionit Bujqësor*, inspektori i Inspektoratit të Mbrojtjes së Tokës (IMT), në qark dhe përgjegjësi i ZMMT-së në bashki ose të jetë i dokumentuar nga IMT-ja, sipas procedurave të përcaktuara në pikat 5 deri në 8 të kreut IV të vendimit nr. 80, datë 28.1.2005 të Këshillit të Ministrave “Për përbërjen, mënyrat e funksionimit, detyrat dhe përgjegjësitë e strukturave shtetërore të mbrojtjes së tokës bujqësore”.

2. Dëmtimi i tokës bujqësore nga faktorë të fuqisë madhore, të evidentuara sipas pikës 1 të këtij kreu, verifikohet nëpërmjet analizave të vlerave të treguesve të tokës bujqësore, që kryhen nga QTTB-ja, sipas përcaktimeve në pikat 1 dhe 2 të kreut IV të këtij vendimi.

Kërkesës për kryerjen e analizave të vlerave të treguesve të tokës, veç përmbajtjes së përcaktuar në pikën 1 të kreut IV të këtij vendimi, i shtohet edhe dokumentacioni që evidenton dëmtimin e tokës, i mbajtur sipas përcaktimit të pikës 1 të këtij kreu.

3. Subjekti i interesuar për ndryshimin e tokës bujqësore dhe kalimin e saj në kategori të resursit tokë e pafrytshme, në varësi të rezultateve të analizave, raportit teknik dhe rekomandimeve të QTTB-së, mund të paraqesë kërkesë në MBUMK.

4. Struktura që mbulon administrimin e tokave në MBUMK shqyrton mbështetjen ligjore të kërkesës dhe dokumentacionin përbërës të tij.

Në rastin e vlerësimit pozitiv të kërkesës, MBUMK-ja përgatit:

a) urdhrin e ministrit për miratimin e ndryshimit, kur sipërfaqja objekt kërkesë është deri në 5 (pesë) ha;

b) vendimin e Këshillit të Ministrave, kur sipërfaqja objekt kërkesë është mbi 5.1 (pesë pikë një) ha.

Kur ministri vlerëson se në kërkesë nuk janë përmbushur kriteret e përcaktuara, që sjellin, për pasojë, mosmiratimin e saj, njofton subjektin që ka paraqitur kërkesën.

VI. NDRYSHIMI I TOKAVE BUJQËSORE TË KATEGORIVE NGA V DERI NË X TË BONITETIT DHE KALIMI I TYRE NË TOKË URBANE (TRUALL), NË TOKË PËR VEPRIMTARI MINERARE E GJEOLGJIKE, SI DHE PËR GURORË E KARIERA

1. Subjektet e interesuara për ndryshim të kategorisë së resursit të tokës bujqësore, nga V deri në X të bonitetit, për kalimin e tyre në tokë urbane, truall, në tokë për veprimtari minerare e gjeologjike, për gurorë dhe

karriera, në bashkitë ku nuk janë miratuar planet e përgjithshme vendore, paraqesin kërkesë në ministrinë përkatëse që mbulon këtë veprimtari. Kërkesa paraqitet sipas dispozitave të legjislacionit për planifikimin e territorit dhe përmban edhe vërtetimin për kategorinë e tokës sipas bonitetit, për sipërfaqen objekt kërkesë, të lëshuar nga Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës, e qarkut.

2. Ministria që mbulon veprimtarinë përkatëse merr, paraprakisht, mendimin e MBUMK-së dhe përgatit vendimin e Këshillit të Ministrave, kur kërkesa ka për objekt sipërfaqe toke deri 30 (tridhjetë) ha, apo ligjin kur kërkesa ka për objekt sipërfaqe toke mbi 30 (tridhjetë) ha.

VII. KALIMI I TOKAVE BUJQËSORE TË KATEGORIVE NGA I DERI NË IV PËR NDËRTIME, PËR RASTE TË DOMOSDOSHME

1. *Subjektet e interesuara për të ushtruar veprimtari në tokat bujqësore të kategorive nga I deri në IV të bonitetit, vetëm për rastet e domosdoshme, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 11/1, të ligjit nr. 8752, datë 26.3.2001, “Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës”, të ndryshuar, në bashkitë ku nuk janë miratuar planet e përgjithshme vendore, paraqesin kërkesë në ministrinë që mbulon veprimtarinë përkatëse, sipas dispozitave që rregullojnë veprimtaritë për planifikimin e territorit. Kërkesa duhet të përmbajë edhe vërtetimin për kategorinë e tokës sipas bonitetit, të lëshuar nga Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës, e qarkut.*

2. Ministrinë përkatëse, që mbulojnë veprimtari për të cilën kërkohet kalimi i tokës, marrin paraprakisht mendimin e MBUMK-së dhe përgatit vendimin e Këshillit të Ministrave.

VII/1. KALIMI I TOKAVE TË RESURSEVE TË NDRYSHME NË KATEGORINË E RESURGIT TOKË URBANE, TRUALL, SIPAS PLANEVE TË DETAJUARA DHE PLANEVE TË PËRGJITHSHME VENDORE

Në rastet kur planet e detajuara për zona të rëndësisë kombëtare, planet e përgjithshme vendore dhe planet e detajuara vendore janë miratuar dhe botuar në regjistrin e planifikimit të territorit, subjektet e interesuara për ndryshimin e kategorive të resurseve paraqesin për regjistrim në Drejtorinë e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës, të qarkut, lejen e zhvillimit ose lejen e ndërtimit. Në këto raste, resursi i tokës ndryshohet sipas lejes së zhvillimit ose lejes së ndërtimit, konform planit të përgjithshëm vendor dhe planit të detajuar vendor. Leja e zhvillimit paraqitet për çdo parcelë.

VIII. PËRDITËSIMI NË DOKUMENTACIONIN KADASTRAL TË KALIMEVE DHE NDRYSHIMEVE TË KATEGORIVE TË RESURSEVE

1. *Për kalimet dhe ndryshimet e kategorive të resurseve, të miratuara sipas rastit me akte ligjore apo nënligjore, me planet e detajuara për zona të rëndësisë kombëtare, planet e përgjithshme vendore dhe planet e detajuara vendore dhe mbështetur në to, Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës, e qarkut, ZMMT-ja në bashki, si dhe Drejtoria Rajonale Pyjore bëjnë përditësimin në dokumentacionin kadastral përkatës.*

2. *DAMT-ja në këshillin e qarkut dhe DSHP-ja në rreth, për kalimet dhe ndryshimet e miratuara me akte ligjore apo nënligjore njoftojnë zyrën vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme në rreth, e cila i pasqyron këto ndryshime në llojet e pasurive, sipas pronarëve ose poseduesve të ligjshëm të tyre.*

IX. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Vendimi nr. 655, datë 28.7.2010 i Këshillit të Ministrave “Për rregullat dhe procedurat e ndryshimit të kategorive të resurseve të tokës”, i ndryshuar, shfuqizohet.

2. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, ministria përgjegjëse për mjedisin, strukturat shtetërore të administrimit të tokës në qarqe dhe institucionet e tjera shtetërore të ngarkuara nga ligji për planifikimin e territorit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha